

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-140/12

Prishtinë
12 prill 2013

Në çështjen juridike të:

Y.S.

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

kundër

O. D.

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësja e kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën e ushtruar kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/148/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14022), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 prill 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e H. S. kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/148/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14022), të datës 19 prill 2012.

- 2- Refuzohet si e pabazuar ankesa e Y. S. kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/148/2012, (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14022), të datës 19 prill 2012.
- 3- Vërtetohet vendimi i Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/148/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14022) i datës 19 prill 2012.
- 4- Obligohen palët ankuese që solidarisht t'i paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën prej € 65 (€ gjashtëdhjetë e pesë) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 10 gusht 2006, O. D. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ririposimin e një toke – ngastra nr. 10191 prej 15,61 ari në Prizren (e përshkruar si komerciale, pa ndërtesa). Paraqitësja e kërkesës deklaroi se ajo është bashkë-pronare e pronës.

Për ta mbështetur kërkesat e saj, ajo dorëzoi në AKP dokumentet në vijim:

- Vendimin e trashëgimisë të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren më 18 maj 2001, lënda nr 99/2001, i marrë në një procedurë lidhur me trashëgiminë e nënës së ndjerë të paraqitëses së kërkesës D.J. vendimi ka njohur të drejtat trashëgimore të fëmijëve të saj – ku secilit i takon $\frac{1}{4}$ e pjesës ideale. Njëra nga pronat e përfshira në trashëgimi ishte ngastra e kontestuar;
- Fletën poseduese nr 021, e datës 22 maj 2011, e lëshuar nga Komuna e Prizrenit në emër të paraqitëses së kërkesës dhe tri motrave të saja, ku secila është shënuar si pronare e $\frac{1}{4}$ të pjesës ideale të disa pronave, ndër të cilat është ngastra e kontestuar.

AKP ka informuar palët potencialisht të interesuara rreth kërkesës duke vendosur njoftimin në një garazh që ndodhej në pronë më 5 maj 2010.

Në të njëjtën ditë pala e interesuar I.S. paraqiti një përgjigje duke pretenduar se R. S. (me gjasë babai i tij) e kishte blerë ngastrën.

Për t'i mbështetur pohimet e veta, ai dorëzoi në AKP këto dokumente:

- Një vendim gjyqësor nr 345/1984, lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren, i marrë në një kontest pronësor ndërmjet R..S. dhe V. D. Kjo e fundit që urdhëruar t'ia dorëzojë R. S. ngastrën nr 10190;

Me vendimin KKPK/D/A/148/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA14022), të datës 19 prill 2012, KKPK-ja ka pranuar se kërkesa është e bazuar. KKPK-ja ka pranuar se provat e paraqitura nga paraqitësjja e kërkesës e legjitimojnë atë si pronare e drejtë. Pala përgjegjëse në kërkesë dorëzoi provat lidhur me një ngastër tjetër (10190), në fqinjësi të ngastrës së kontestuar (10191).

Vendimi iu dorëzua paraqitëses së kërkesës më 24 dhjetor 2012 dhe palës përgjegjëse në kërkesë I.S. më 16 tetor 2012.

Më 2 nëntor 2012, I. dhe H .S. paraqitën një ankesë, duke pohuar se prona i përket familjes së tyre dhe se ata e kishin ndërtuar aty një shtëpi para 20 viteve.

Paraqitësjja e kërkesës, tani palë përgjegjëse në ankesë, u përgjigj në ankesë duke thënë se pala ankuese nuk ka ndërtuar shtëpi në atë ngastër, por në një ngastër tjetër. Ajo shtoi se familja e saj e kishte shfrytëzuar ngastrën e kontestuar nr 10191 deri më 1999 dhe se palët ankuese e posedojnë ngastrën fqinjë 10190.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesave:

Ankesa e H.S. është e papranueshme. Ai nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së, edhe pse është njoftuar si duhet rreth kërkesës – shenja e njoftimit ishte vendosur në derën e garazhit të ndërtuar në ngastrën e kontestuar.

Ankesa e I. S. është e pranueshme. Kjo ankesë është paraqitur nga një palë e interesuar, që ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së dhe brenda periudhës 30-ditore pas dërgimit të vendimit, sikurse parashihet me Ligj – neni 12.1 UNMIK/REG/2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Mbi meritat e ankesës së Y. S.:

Gjykata Supreme pas vlerësimit të dosjes, vendimit të ankuar dhe pretendimeve të palës ankuese konsideron se ankesa është e pabazuar.

E drejta pronësore mund të fitohet vetëm me ligji, duke u bazuar në një bartje ligjore (punë juridike) apo trashëgimi – parim themelor në ligjin mbi pronën.

Në rastin konkret është vërtetuar pozitivisht se paraqitësja e kërkesës ka trashëguar të drejtën pronësore mbi ¼ e pjesës ideale të ngastrës së kontestuar. Nuk është arritur të dëshmohet e kundërta se ngastra i takonte trashëgimisë së D. J.; nëna e paraqitëses së kërkesës.

Nga ana e tij, pala përgjegjëse në kërkesë është dashur të dëshmoj se ai ka të drejtë legjitime t'i hedh poshtë pretendimet e paraqitëses së kërkesës, të cilën nuk e ka bërë. Në procedurë civile çdonjëri ka për detyrë të paraqesë prova për faktet në bazë të së cilave pretendon t'i ketë fituar të drejtat – argumenti sipas nenit 7.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, që thotë se pala obligohet t'i paraqesë të gjitha faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta dhe i dorëzon provat që i vërtetojnë ato fakte.

Pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë provë se familja e tij ka ndonjë të drejtë lidhur me ngastrën 10191. Ai paraqiti prova se familja e tij ka të drejta mbi ngastrën fqinje – 10190. Në dosje po ashtu është një fotografi e ngastrës 10191 ku shihet qartë se nuk ka shtëpi të ndërtuara aty ndërsa janë dy shtëpi të ndërtuara në ngastrën fqinje, në vijën kufizuese me ngastrën 10191 (shtëpitë gjoja të ndërtuara nga familja e palës ankuese). Është e qartë se pala ankuese ka ngatërruar kufijtë e ngastrës së tij – 10190 ose thjeshtë dëshiron t'i "zgjerojë" të drejtat e veta drejt ngastrës fqinje, e cila nuk i përket atij.

Prandaj, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe ligjor dhe duhet të vërtetohet sikurse parashihet në nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Respektivisht, ankesat refuzohen.

Shpenzimet e procedurës

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor

1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronave në fjalë (1/4 pjesë e ngastrës) në mënyrë të arsyeshme mund të përlogaritet në € 4000 dhe është € 25,00.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, t afati për pagesën e taksave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nuffer, Referent i EULEX-it